



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 336, datë 24.09.2020

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) TË GJYQITARËVE QË KANË KALUAR ME SUKSES PROCESIN E RIVLERËSIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 89, pika 1 dhe 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, 63 dhe 86, shkronja “dh” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, bazuar në “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020” dhe dosjet e dërguara nga organet e rivlerësimit, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

V E N D O S I :

- I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional.
- II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 1. Për gjyqtarin z. {...}– Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}.
 2. Për gjyqtarin z. {...}– Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. {...}
 3. Për gjyqtaren znj. {...}- Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR